

V E N D I M
Nr. 41, datë 17.5.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 13.03.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.26 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: Gaspër Elezaj, i përfaqësuar nga avokati Ali Metaj, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:Këshilli i Lartë i Drejtësisë, i përfaqësuar nga inspektori Alfred Progonati, me autorizim.

O B J E K T I:

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.70, datë 12.2.2000 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr.1348, datë 1.11.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Për shfuqizimin si antikushtetues të këtyre vendimeve, kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe:

1. Shkeljet e konstatuara në gjykimin e çështjeve penale e civile nuk janë të tilla që të trajtohen si akte apo sjellje që diskreditojnë rëndë figurën e gjyqtarit dhe autoritetin e drejtësisë, siç është përcaktuar në nenin 147 pika 6 të Kushtetutës dhe neneve 40 e 42 të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”. Ato janë të lidhura me punën e ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”. Ato janë të lidhura me punën e përditshme të çdo gjyqtari.

2. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, si organ administrativ, duhej të zbatonte vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe të merrte një masë tjetër disiplinore përveç shkarkimit nga detyra. Ai ka vepruar në kundërshtim me nenin 44/1 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998, pasi si organ i paanshëm që shqyrton kërkesën për procedim disiplinor, nuk duhet ta kërkojë vetë apo ta vërë në lëvizje këtë procedim.

3. Zvarritjet në gjykim kanë ndodhur për organizim të punës për të cilin është vënë në dijeni kryetari i gjykatës.

4. Kolegjet e Bashkuara e gjykuan çështjen në datën 1.11.2000, por nuk e shpallën vendimin.

5. Arsytimi i vendimit të Gjykatës së Lartë, vjen në kundërshtim me provat e shqyrtuara në seancë gjyqësore, me relacionet e Inspektoratit e kërkesat për procedim disiplinor, por edhe me vetë vendimin e mëparshëm të saj.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatorin Kristofor Peçi, kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili është lënë në fuqi nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kërkuesi Gaspër Elezi, është shkarkuar nga detyra e gjyqtarit të shkallës së parë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër me motivacionin “për zvarritje të rënda dhe sistematike në kryerjen e detyrës, për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, si dhe për moskryerje të veprimeve të detyrueshme procedurale”.

Në kundërshtim me sa ka parashtruar kërkuesi në kërkesën e tij, Gjykata Kushtetuese çmon se nuk ndodhemi para një procesi të parregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

Kërkuesi, duke argumentuar se shkeljet nuk janë të tilla që të trajtohen si akte apo sjellje që diskreditojnë rëndë figurën e gjyqtarit dhe autoritetin e drejtësisë, siç kërkon neni 147/6 i Kushtetutës, pranon shkeljet e kryera prej tij. Përsa i përket vlerësimit të tyre, karakterit të rëndë apo diskreditues, shkallës së përgjegjësisë etj., këto janë bërë nga organet që kanë gjykuar çështjen, si Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat kanë vendosur sipas kompetencave. Përderisa kërkuesi nuk i ka kontestuar shkeljet dhe nuk ka parashtruar argumente për proces të parregullt, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, nuk i takon Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë shkeljet për masën e marrë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Pretendimi se Këshilli i Lartë i Drejtësisë ishte i detyruar të zbatonte vendimin e Kolegjeve të Bashkuara për të marrë një masë tjetër disiplinore veç shkarkimit nga detyra dhe se ai ka vënë në lëvizje procedimin disiplinor ndaj kërkuesit, nuk qëndron. Nga aktet rezulton se me shkresën nr.3160/1, datë 15.9.1999 të Ministrit të Drejtësisë është kërkuar verifikimi i të dhënave para fillimit të procedimit disiplinor për kërkuesin dhe se masa e shkarkimit nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë është marrë pas këtij verifikimi, duke u njohur në kohë kërkuesi me rezultatet e kontrollit.

Përsa i përket pretendimit për mosshpallje të vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, edhe nëse është i vërtetë, për rastin konkret nuk ka ndikuar në zgjidhjen e çështjes.

Në këto kushte meqënëse kërkuesi nuk parashtron argumente për proces të parregullt ligjor, kërkesa e tij duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 gërma “f” të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Kërkesa e gjyqtarit Gaspër Elezaj duhet të ishte pranuar për këto shkaqe:

1. Formulimi i pikës 6 të nenit 147 të Kushtetutës garanton parimin e patundshmërisë së gjyqtarit. Duke përcaktuar në mënyrë të qartë e të plotë rastet kur gjyqtari mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Kushtetuta nuk lejon që shkarkimi të bëhet edhe për raste të tjera të parashikuara nga ligje të veçanta. Për këto raste të fundit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë mund të marrë masa të tjera disiplinore të shkallës më të ulët, por jo shkarkim nga detyra. Në vendimin nr.70, datë 12.2.2000 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili është lënë në fuqi me vendimin nr.1348, datë 1.11.200 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, thuhet se shkarkohet nga detyra gjyqtari Gaspër Elezaj me motivacionin: “për zvarritje të rënda dhe sistematike në kryerjen e detyrës, për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e detyrës, si dhe për moskryerje të veprimeve të detyrueshme procedurale”.

Ky motivacion, i cili përbën edhe shkakun e largimit nga detyra, është krejtësisht i ndryshëm nga kriteret e përcaktuara në nenin 147/6 të Kushtetutës. Termat e Kushtetutës “për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë figurën e gjyqtarit” ose “pamjaftueshmëri profesionale”, që mund të përligjin marrjen e kësaj mase ekstreme, as që janë përmendur fare në vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kur këto vendime duhet të ishin arsyetuar pikërisht mbi këtë bazë.

Këtë qëndrim ka mbajtur Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.29, datë 30.4.2001 që i përket kërkesës së gjyqtarit Ardian Kalia. Duke analizuar se Këshilli i Lartë i Drejtësisë në përzgjedhjen e masës disiplinore nuk ka patur sa duhet parasysh edhe kërkesat e nenit 147 pika 6 të Kushtetutës, në

vendim përmendet se zbatimi i kësaj dispozite kushtetuese është lidhur vetëm me kryerjen e akteve që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Në vazhdim, ky vendim konstaton se Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk kanë argumentuar se cilat janë shkaqet e vërteta të shkeljeve që i atribuohen kërkuesit, nëse ato janë rezultat i veprimeve me dashje që diskreditojnë pozitën e tij si gjyqtar apo janë gabime të zakonshme që mund të kenë ardhur nga mungesa e përvojës së tij në këtë detyrë.

2. Vlerësimi i vendimeve të gjykatës nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe mbi këtë bazë marja e masës disiplinore ndaj gjyqtarit është veprim antikushtetues. Për vendimet e gjykatave mund të vendosë vetëm gjykata më e lartë dhe asnjë organ tjetër. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ndonëse është një organ i ngarkuar nga Kushtetuta për të marrë masa disiplinore ndaj gjyqtarëve deri në shkarkimin e tyre, duke mos qenë instancë më e lartë gjyqësore, nuk ka kompetencë as të cenojë dhe as të vlerësojë përmbajtjen e vendimeve të gjykatave. Pasoja negative të një veprimi të tillë antikushtetues do të dukeshin qartë në rast se këto veprime të vlerësuara të padrejta nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe që pasohen me shkarkimin nga detyra të gjyqtarit, do të konsideroheshin të bazuara nga instancat më të larta gjyqësore.

Në rrethana të njëjta, Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.29, datë 30.4.2001, ndër të tjera, shprehët: “vendimet gjyqësore të formës së prerë, për çështjen konkrete që zgjidhin, kanë fuqinë e ligjit. Kjo do të thotë që për sa kohë ato nuk janë prishur ose ndryshuar nga një gjykatë më e lartë, asnjë organ tjetër shtetëror nuk mund të mos përfillë përmbajtjen e tyre dhe të ngarkojë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes”.

Përderisa edhe në rastin e kërkuesit Gaspër Elezaj, kemi të bëjmë me vlerësime të vendimeve nga një organ tjetër dhe jo nga Gjykata, duhet të ishte mbajtur i njëjti qëndrim si në vendimin e sipërcituar të Gjykatës Kushtetuese për pranimin e kërkesës.

Anëtar
K.Peçi

Anëtar
Z.Vuci

NDREQJE GABIMI

Në Fletoren Zyrtare nr.24, viti 2001, në ligjin nr.8781, datë 3.5.2001 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, në faqen 760, në nenin 18, numri “69” bëhet “60”; në nenin 19 , në rreshtin e nëntë, fjala “të shoqatës” bëhet “të fondacionit”.